

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË RROGOZHINË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Rrogozhine, me objekt: “Mbi Vlerësimin e aktivitetit ekonomik-financiar, zbatimin e Planit Rregullues të Përgjithshëm, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit të aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, legalizimin e shtesave në ndërtime, dhënien me qira të objekteve pronë publike, masat për mbrojtjen e mjedisit , vlerësimi i Auditit të brendshëm etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 7, datë 25.01.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 333/6, datë 26.01.2012, dërguar z. **Ndriçim DUSHKU**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

I – Për Zyrën e Urbanistikës

1. Të shoqërohen dhe të paraqiten në KRRT për miratim:

a- Vetëm ato kërkesa për sheshe ndërtimi të cilat janë të shoqëruara me dokumentin e pronësisë sipas modelit të miratuar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, (vërtetim pronësie ose certifikatë pronësie, shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme të lëshuara nga ZVRPP-ja Kavajë).

b- Vetëm ato kërkesa për leje ndërtimi, të cilat kanë bashkëlidhur licencën e personit juridik ndërtues, në zbatim të nenit 45 të ligjit: nr. 8405, datë: 17.09.1998 “Për Urbanistikën”.

c- Vetëm ato kërkesa për leje sheshi e ndërtimi të cilat formularët 1, 3 dhe 3/1 i kanë të plotësuar në rubrikën mendimi i Zyrës Urbanistike sipas përkatësisë.

Vazhdimisht

2. Të mos pranoj dhe të mos shqyrtoj kërkesa për leje shfrytëzimi:

a- kur ka mos zbatim të projektit të miratuar në lejen e sheshit të ndërtimit, në zbatim të pikës “ç” të nenit 11 të ligjit: nr. 8402, datë: 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe, në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë: 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

b- Kur dosjet nuk janë plotësuar me akt - kontrollet për piketimin e objektit, përfundimin e themeleve dhe përfundimin e karabinasë, në zbatim të nenit 54 të ligjit: 8405, date: 17.09.1998, “Për Urbanistikën”.

c- Kur nuk është paraqitur relacioni i mbikëqyrësit të punimeve, licenca e mbikëqyrësit të punimeve e kolaudatorin, në zbatim të nenit 11, 12, dhe 13 të ligjit: nr. 8402, datë: 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Vazhdimisht

3 - Të marr miratimin nga KRRTRSH –ja për Planin Rregullues i Qytetit Rrogozhinë”, i cili është likuiduar me urdhër pagesën nr. 10, datë 28.12.2006.

Menjëherë

4. Nga Zyra e Arkivit të Urbanistikës, të merren masa që i gjithë dokumentacioni përfundimtar i ndodhur në dosjet e KRRT- së, që kanë mbaruar procesin e dhënies së lejes të shfrytëzimit dhe të dërgimit të dokumenteve në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe që janë të arkivuara, të jenë me fletë inventari, të sistemuara dhe të inventarizuara, në përputhje me nenin 24, germa b, të ligjit: 9154, datë: 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe nenet 4 dhe 5 Kapitulli II-të mbi “Detyrat e sekretarit – arkivit të organit shtetëror” të “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore”.

Vazhdimisht

II- Për Këshillin e Rregullimit të Territorit

1. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Rrogozhinë, të mos miratoj Studime Urbanistike Pjesore për sa kohë që nuk ka një Studim Urbanistik Rajonal dhe Mjedisor të miratuar nga KRRTSH-ja.

Vazhdimisht

IV- Për Zyrën Juridike

1. Të gjitha kontratat që do të lidhen ndërmjet përfaqësuesit të institucionit dhe subjekteve të ndryshme të kryen në prezencë të noterit. Në zbatim të nenin 49 të ligjit nr 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”

Vazhdimisht

II- Për Zyrën e Tatim Taksave

1. Sektori i taksave vendore të marrë masa:

-për realizimin dhe rritjen e të ardhurave vendore si dhe për planifikimin e saktë të disa taksa vendore të cilat kanë rezultuar me rezerva si taksa e pastrimit familjar etj.

-për kontrollin në terren ndaj subjekteve fizike që vet deklarojnë xhiro vjetore minimale dhe për kontrollin e subjekteve që nuk janë verifikuar asnjëherë si dhe atyre që kanë ngarkesë të njëjtë për çdo vit.

-për kompletimin e dosjeve me dokumentacionin e duhur sidomos me dokumentin e hipotekës për efekt të llogaritjes taksës së ndërtesës.

Menjëherë

2. Zyra e taksave vendore të rakordojë me Policin e Komunës për të marrë masa:

- për licencimin e 25 subjekte që nuk janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit QKR, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 39 dhe 40 (detyrat e tatimpaguesit për regjistrim).

Menjëherë

-për vjeljen e vlerës **4.740.540 lekë për 114 subjekte dhe vlera 242.687 lekë** nga fermerët për taksën e tokës bujqësore të cilat rezultojnë debitorë për mos shlyerjen e taksave e tarifave vendore për vitin 2010, në kundërshtim me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 neni 49 “Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin”, pika 1, dhe në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998.

Menjëherë

IV. Zyra e Financës në bashkëpunim me zyrën e Taksave të kontabilizoj debitorët nga biznesi që nuk kanë shlyer detyrimet.

Menjëherë

- Të çoj për të regjistruar në ZVRPP, objektet ndërtimore që aktualisht janë të pa regjistruar, në zbatim të vendimit e KM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pasurisë paluajtshme shtetërore dhe transformimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe Udhëzimin e KM nr 3, datë 18.07.2002 dalë në zbatim të tij dhe nuk kanë certifikatë pronësie.

Menjëherë

- Të marri në dorëzim dhe të bëjë inventarizimin e objektit shkolla “Xhorxh Sorros” është ndërtuar me fonde të Bankës Botërore për Zhvillim”, pajisur me materiale nga bashkia Rrogozhinë. Në zbatim të ligjin nr 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Menjëherë

4. Kryetari i Bashkisë, të ngrejë komisionin e asgjësimit të materialeve jashtë përdorimit, të cilat janë të pa grumbulluar dhe janë lënë në inventar të punonjësve. Këto veprime bien ndesh me kreun V të ligjit nr 6942, datë 25.12.1984 ” Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” dhe neni 16 e 17 të vendimit të KM nr 70, datë 11.03.1995 dalë në zbatim të ligjit mësipërm.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore detyrimi 508 693 lekë dëm ekonomik, përkatësisht:

1- Në 1 raste shpërblim dëmi nga [] në shumën 142 193 lekë, ka përfituar padrejtësisht dy pagesa brenda kohës normale të punës, në kundërshtim me nenin 18 pika 1, 19 pika c dhe 20 pika ç, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”.

Menjëherë

2. Shuma 146 500 lekë, nga firma [], për punime të pa kryera në tenderin me objekt: “Rikonstruktion dhe asfaltim i rrugës së varrezave” në kundërshtim me Kontratën Nr. reference s’ka, datë 06.05.2009 dhe të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit “ neni 8 e 11, me UKM nr. 2, date: 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

Menjëherë

3. Shuma 114 400 lekë, nga firma [], për punime të pa kryera në tenderin me objekt: “ Rikonstruktion i rrugës qendër Qyteti – Stacioni i Trenit- Ura” Rrogozhinë. në kundërshtim me Kontratën Nr. reference s’ka, datë 06.05.2009 dhe të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit “ neni 8 e 11, me UKM nr. 2, date: 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” .

Menjëherë

5. Shuma 105 600 lekë, nga firma [], për punime të pa kryera në tenderin me objekt: Rikonstruktion I katit përdhe I “Zyrave” të Bashkisë. në kundërshtim me Kontratën Nr. reference s’ka datë 14.12 2009 dhe të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit “ neni 8 e 11, me UKM nr. 2, datë: 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të , nenet 15 e 16, Bashkia Rrogozhinë t’ i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë që për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit të gjobitë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve të ndërtimit si më poshtë:

1. Gjobë në masën 50 000 lekë , për z [REDAKTUAR] me cilësinë e mbikëqyrëses të punimeve, në tenderin me objekt : “ Rikonstruksion i rrugës qendër Qyteti – Stacioni i Trenit- Ura” Rrogozhinë

-mos kryerjen e detyrës për verifikimin e zërit të punimeve ku rezultuan me diferencë më pak në 1 tender punimesh duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik prej **114 400 lekë**, në kundërshtim me kontratën e punimeve Nr. reference s’ka, datë 06.05.2009 dhe nenet 7 dhe 11 të ligjit nr, 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“.

-kreun e parë, pikat 1/2, 3, 3/1, kreu II pika 1/b, c, ç, të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

-pikën 4 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

2. Gjobë nga 50 000 lekë , për Firmën [REDAKTUAR] për kolaudatorët, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me cilësinë e mbikëqyrësi të punimeve, në tenderët me objekt:

“ Rikonstruksion i rrugës qendër Qyteti – Stacioni i Trenit- Ura” Rrogozhinë

-mos kryerjen e detyrës për verifikimin e volumit faktik ku rezultuan me diferencë më pak në tendera punimesh duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik prej **114 400 lekë**, në kundërshtim me kontratën e punimeve dhe nenet 7 dhe 11 të ligjit nr, 8402 datë 10.09.1998 ”Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit“.

-kreun e parë, pikat 1/2, 3, 3/1, kreu II pika 1/b, c, ç, të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

-pikën 4 të udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25, pika 3, shkronjat “a”,”ç”, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”; pikën 1, shkronjat (a) dhe (ë) të VKM nr. 306, datë 13.06.2000“Për disiplinën në shërbimin civil”dhe Kontratat individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Komunës, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

I.”Vërejtje me shkrim” neni 25, pika 3, germa “a” për :

1. z. ■ me detyrë K/ Inspektor i NUS

- ka ushtruar 5 kontrole dhe janë mbajtur 5 proces verbale.

- një në bashkinë Rrogozhinë një në komunën Lekaj dhe një në komunën Luz i Vogël.

- ka marrë 5 vendime për kthimin në gjendjen e mëparshme të tokës.

Nuk ka asnjë dokumentacion që të tregoj që këto vendime janë zbatuar.

- në asnjë rast, nuk janë kryer matjet dhe nuk është hartuar dokumentacioni paraprak në terren.

- në asnjë rast, nuk është vendosur asnjë gjobë për kundërvajtësit sipas Vendimit nr. 4, datë: 19.07.2010, kjo tregon punën e dobët të këtij inspektorati.

- në asnjë rast, nuk është mbajtur akt verifikim, për gjithë ato objekte që u është miratuar leja e ndërtimit por që nuk është zbardhur leja, për mos fillimin e punimeve për ndërtim pa leje.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Piro Imeraj, Sotir Kozdine dhe Antoneta Zotaj.

Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i

Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë

Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT